



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.3/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit: Qeveria e Kosovës-Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës me adres ish ndërtesa e Gërmisë- Prishtinë, kundër debitorit: I.P. Sh.p.k (A...) me numër të biznesit me pronar M.H. nga fshati-Komuna e Suharekës, që ka të bëjë me pagesën e faturës-borxhit, si objekt i përbarimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit përbarimor të lejuar nga Zyra Përbarimore Vais Law me Përbaruesin Privat Isa Gacaferi P.nr.991/2014 të dt:10.12.2014, mbi caktimin e përbarimit, me dt:06.09.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET, prapësimi i debitorit: I.P. Sh.p.k (A...) me numër të biznesit me pronar M.H. nga fshati-Komuna e Suharekës, i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat P.nr.991/2014 të dt:10.12.2014, **si i bazuar**.

II.SHFUQIZOHET Urdhrit të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi P.nr.991/2014 të dt:10.12.2014, mbi caktimin e përbarimit.

III. PËRFUNDOHET, procedura përbarimore KPPP.nr.3/22 dhe **abrogohen** të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesit privat me seli të zyrës në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm– faturës B-23/2013 e datës 17.04.2013 e cila paraqet dokument përbarues në bazë të nenit 21 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka deklaruar se krejtësisht është e vërtet se ndaj kreditorit kam një obligim për shfrytëzimin e brezit rrugor në fshatin, por kreditorja nga unë ka marre një ankesë me numër 583/2014 me datën 19.06.2013 me të cilin ankesë i është sqaruar kreditores se ky shfrytëzim

real mund të jetë 120mk. Debitori tutje ka shtuar se kërkesat e tilla janë të dyshimta dhe kontestuese sidomos në rastin konkret, prandaj meqë janë të tilla kërkesat i tejkalojnë mundësit reale për përmbarrim, andaj duhet të ndërpritet procedura e përmbarrimit dhe lënda të dërgohet në gjykate të rregullt.

Duke u bazuar në të lartcekurat, debitori i përmbarrimit i kishte propozuar Gjykatës që prapësimin e debitorit të aprovoj dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Kundër prapësimin të debitorit, kreditori kishte ushtruar përgjigje në prapësim me të cilin kishte theksuar se duhet të hedhen poshtë pretendimet e debitor ngase fatura B-23/2013 është llogarit sipas Udhëzimit Administrativ 2005/13 për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 2004/5 i cili cakton tarifën për kyçe në rrugë dhe shfrytëzimin e tokës e cila i takon rrugës magjistrale dhe regjionale i cili udhëzim ka hyrë në fuqi me datën 14.11.2005. Po ashtu kreditori kërkon se prapësimi të hidhet poshtë si pas afatshëm meqenëse të njëjtin debitori e ka paraqitë jashtë afatit ligjor. Prandaj kreditori i ka propozuar gjykatës se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të miratoj urdhrin përmbarrimor dhe debitorit t'ia refuzoj prapësimin.

Fillimisht gjykata vlerësoj afatshmërinë e prapësimin ngase ishte pretendim i kreditorit të përmbarrimit, mirëpo gjatës shikimit të shkresave të lëndës gjykata vërtetoi se propozimi për përmbarrim dhe urdhri përmbarrimor ishte pranuar nga debitori me datë 22.01.2015, ndërsa prapësimi i debitorit në zyrën përmbarrimore të përmbarruesit privat ishte dërguar me 28.01.2015 që do të thotë brenda afatit të paraparë ligjor, andaj një pretendim i tillë për gjykatën është i pa qëndrueshëm.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve prapësuese me prapësimin të debitorit të përmbarrimit, propozimit për përmbarrim dhe analizimit të shkresave të lëndës, me rastin e rishikimit të procedurës në këtë çështje përmbarrimore, vendosi se përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarrimor për faktin se, dokumenti i besueshëm-fatura me B-23/2013 e datës 17.04.2013, nuk është pranuar nga debitori i përmbarrimit, këtë fakt Gjykata vërteton se fatura e cila është objekt i përmbarrimit është dërguar tek debitori, por e njëjta nuk është e konfirmuar nga debitori se është pranuar në mënyrë të rregullt, prandaj gjykata erdhi në përfundimin se përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarrimor të parapara me dispozitat e LPP-së konkretisht nënenin 29 par.3, për faktin se dokumenti i besueshëm-fatura me numër B-23/2013 e datës 17.04.2013 mbi bazën e të cilave është ushtruar propozimi për përmbarrim, nuk është e papërshtatshme për përmbarrim, sepse nuk është pranuar dhe nënshkruar nga debitori i përmbarrimit, fatura si objekt i përmbarrimit nuk është në përputhje të nënit 37 të LPP-së ngase e njëjta është dërguar në kopje, andaj se e tillë nuk mund të trajtohet se dokument i besueshëm.

Pas konstatimit të gjendjes faktike në këtë procedurë përmbarrimore, gjykata ju referua nënit 43.4 të LPP-së në të cilin ndër të tjera është rregulluar se: “ Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Nga arsyet e paraqitura, e në bazë nenin 43 par. 4 dhe 73 të LPP-së si dhe për Plotësim Ndryshimin e ligjit e me numër Nr.05/L-118 te ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.3/22, dt.06.09.2022

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.